



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“Luigj Gurakuqi”

SENATI

Nr. 3019 prot.

Shkodër, më 07.09. 2016

RELACION

Mbledhja e Senatit Akademik e datës 07.09.2016.

Senati Akademik (SA) i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në mbledhjen e tij të dates 07.09.2016, trajtoi çështjet e mëposhtme:

1. Organizimin e Këshillit të Etikës të USH-së, në mbështetje të nenit 44 pika 1, 2, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH-së”, dhe bazuar në nenin 16; pika 2,3 të Statutit të USH-së
2. Miratimin e tarifës së rregjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve (Bachelor), sistemi me kohë të plotë, për vitin akademik 2016-2017 në USH, në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH” neni 6/ pika 29, neni 108, 109; Udhëzimit të MAS nr.13, datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe rregjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, me karakter profesional, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në IAL, për vitin akademik 2016-2017”.

Përsa i përket pikës së parë të agjendës së mbledhjes, mbështetur në nenin 44 pika 1, 2, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH-së”, dhe bazuar në nenin 16 dhe pika 2,3 të Statutit të USH, Rektori propozoi kandidatët e mëposhtëm për anëtarë të Këshillit të Etikës të USH-së pasi i ishte marrë miratimi me shkrim i tyre për t'u angazhuar si anëtar i këtij organi kolegjal:

1. Adem Bekteshi (Kryetar)
2. Mimoza Priku (Anëtar)
3. Sandër Broci (Anëtar)
4. Fatbardha Osmanaga (Anëtar)
5. Ermira Kalaj (Anëtar)

Ky propozim i Rektorit u miratua unanimisht nga SA i USH-së.


Në lidhje me pikën e dytë të agjendës së kësaj mbledhje, pas diskutimeve nga anëtarët e SA të USH-së mbi nevojën e ndryshimit të tarifës egzistuese të rregjistrimit në programet e ciklit

të studimeve (Bachelor), sistemi me kohë të plotë SA miratoi unanimisht ndryshimin e kësaj tarife nga 1600 (një mijë e gjashtë qind) lek në 2000 (dy mijë) lek për vitin akademik 2016-2017. U la detyrë ti kalohet për miratim Bordit të Administrimit të USH.

Relacioni mbi mbledhjen e Senatit Akademik të USH-së të datës 07.09.2016 do të pasqyrohet në website të USH-së.

Sekretari i Senatit

Prof. as. dr. Mirjam Dibra



Kryetari i Senatit

Prof. dr. Adem Bekteshi

